

# S I L L A B U S

<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Filozofik - Dega e Historisë (Universiteti i Prishtinës)</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>GJEOGRAFI HISTORIKE DHE HARTOGRAFI</b>
<b>Niveli:</b>	<b>BACHELOR</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i dytë, sem. 4 (veror)</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+0</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>4 ECTS</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E premte/ 09:00-11:15</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. dr. Gazmend Rizaj</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:gazmend.rizaj@uni-pr.edu">gazmend.rizaj@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Duke qenë se kjo lëndë korrespondon me vitin e dytë të studimeve, kur studenti ndjekë lëndët nga periudha antike dhe mesjetare, atëherë nuk është e rastit që edhe kjo lëndë afron informacione pikërisht mbi gjeografinë historike dhe hartografinë e periudhave gjegjëse, duke filluar nga Lindja e Lashtë, Greqia e Roma, pastaj duke vazhduar me Mesjetën e Hershme dhe të Vonshme Evropiane dhe Amerikane, pastaj me Gjeografinë Historike Arabe, e për të përfunduar me fillimet e Modernitetit të Hershëm nëpërmjet Zbulimeve të Mëdha Gjeografike – me një fjalë, një vertikale gjeografiko-historike nga Menesi deri të Magelani.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kjo lëndë ka për qëllim që studentit t’i ofrojë një qasje specifike ndaj problemeve gjeografiko-historike. Në fakt, Gjeografia Historike si disiplinë shkencore shfrytëzon rezultatet shkencore të historisë e të gjeografisë dhe studenti ka mundësi të pajiset me dituri relevante mbi shtrirjen gjeografike të popujve dhe shteteve gjatë antikitetit dhe mesjetës, mbi rolin e rrethanave gjeografike, sidomos klimës dhe resurseve natyrore në rrjedhën e zhvillimit të shoqërisë, dhe anasjelltas. Krahas objektivave që shtron Gjeografia Historike si disiplinë shkencore, brenda kësaj lënde vëmendje e theksuar i kushtohet edhe hartografisë, përkatësisht historisë së hartografisë dhe rolit të saj për historianin. Kjo lëndë nuk është e rëndësishme vetëm për studentët e historisë, por edhe për studentët e gjeografisë, etnologjisë, sociologjisë, shkencave politike etj.

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Studentët që vijojnë këtë lëndë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. do ta zhvillojnë sensin për orientim më të mirë në hartat historike dhe për shfrytëzim të drejtë të shënimeve relevante për historinë nga hartografitë antikë dhe mesjetarë (për ubikimin e toponimeve, mikrotoponimeve, hidronimeve, oronimeve etj.);</li> <li>2. do të krijojnë përfytyrim të qartë mbi lidhshmërinë dhe domosdonë e lidhshmërisë së shkencave, sidomos historisë dhe gjeografisë;</li> <li>3. do ta kuptojnë me shembuj konkret rolin e rrethanave gjeografike në zhvillimin historik të shoqërisë;</li> <li>4. do të demonstrojnë praktikisht dituritë e fituara nëpërmjet interpretimit të të dhënave në hartat e vjetra dhe krahasimit të tyre me hartat aktuale.</li> </ol>
---	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit - korrespondon me rezultatet e të nxënit të studentit**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej - orë
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.30	6 ditë/javë	3
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare	4	2 ditë/javë	8
Detyra të shtëpisë	1	5 ditë	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	21 ditë/3 javë	21
Përgatitja përfundimtare për provim	1	7 ditë	7
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2 javë	4
Projektet, prezentimet, etj	2	4 ditë	8
<b>Totali</b>			<b>101:25 = 4 ECTS</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjëratat janë interaktive. Gjatë ligjëratave studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë diskutime jo vetëm me rastin e elaborimit të njësisë nga ana e mësimdhënësit por edhe gjatë trajtimit të eseve-projekteve hartografike të punuara dhe prezentuara nga studentët. Esetë punohen individualisht apo në grupe. Mësimdhënia zhvillohet rregullisht me ndihmën e video-projektorit me programin <i>PowerPoint Presentation</i> . Gjatë orëve mësimore verifikohet aftësimi i studentëve në orientimin e tyre në hartë.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vijimi i rregullt 5%</li> <li>• Kollokviumi 1 10%</li> <li>• Kollokviumi 2 15%</li> <li>• Aktiviteti në ligjërata 5%</li> <li>• Punimi seminarik 10%</li> <li>• Provimi final 55%</li> <li><b>Totali 100%</b></li> </ul>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Gazmend Rizaj, <b>Gjeografi Historike dhe Hartografi</b> , Universiteti i Prishtinës & WUS-Austria, Prishtinë, 2007.
<b>Literatura shtesë:</b>	Agim Shehu, Pal Nikolla, <i>ELEMENTE TE HARTOGRAFISË</i> ; Pierre Cabanes, <i>HISTORIA E ADRIATIKUT</i> ; Johannes Brondstend, <i>THE VIKINGS</i> ; Frenk Borlow, <i>WILLIAM I AND NORMAN CONQUEST</i> ; Macmillan, <i>AN ADVANCED HISTORY OF INDIA</i> Carlo M. Cipolla, <i>EUROPEAN CULTURE AND OVERSEAS EXPANSION</i> ; <i>ATLLAS I HISTORISË</i> ; Andeas Briken & Hans Hencingig, <i>ATLLAS I HISTORISË</i> ; Valter Shtylla, <i>RRUGËT DHE URAT E VJETRA NË SHQIPËRI</i> , Tiranë, 1998. S.Cvajg, <i>MAGELANI</i> , Tiranë, 1979; I. P. Magidoviç, <i>MBI HISTORINE E ZBULIMEVE GJEOGRAFIKE</i> , Tiranë, 1967; Bagrow, Leo, <i>History of Cartography</i> , Cambridge, Massachusetts, 1964; Gilbert, Martin, <i>The Routledge Atlas of British History</i> , London, 2004; Hupchick, Dennis P. and Cox Harold E. <i>The Palgrave Concise Historical Atlas of the Balkans</i> . New York: Palgrave, 2001; Magocsi, Paul Robert. <i>Historical Atlas of East Central Europe</i> . Seattle: University of Washington Press, 1993; Page, Hake, <i>In the Hands of the Great Spirit - The 20,000-year History of American Indians</i> , New York, 2003;

	<p><i>Salentiny, Fernand, The Encyclopedia of World Explorers, Lisse, 2004; Shukriu, Edi, Historia e Kohës së Vjetër-Lindja e Lashtë, Prishtinë, 1995; Wigal, Donald, Historic Maritime Maps 1290-1699, New York, 2000.</i></p> <p><b><i>Preferohet shfrytëzimi i burimeve nga Interneti!</i></b></p> <p><b>Vërejtje:</b> Pjesa më e madhe e titujve të cekur më lartë gjenden në bibliotekën e Fakultetit Filozofik të UP.</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<b>Diskutim i sillabusit; Objekti i studimit të Gjeografisë Historike dhe Hartografisë; Burimet</b>
<b>Java e dytë:</b>	<b>Lindja e Lashtë - Gjeografia Historike dhe Hartografia</b>
<b>Java e tretë:</b>	<b>Greqia dhe Maqedonia e Lashtë - Gjeografia Historike dhe Hartografia</b>
<b>Java e katërt:</b>	<b>Roma e Lashtë - Gjeografia Historike dhe Hartografia</b>
<b>Java e pestë:</b>	<b>Kontinenti Amerikan në Lashtësi - Gjeografia Historike</b>
<b>Java e gjashtë:</b>	<b>KOLLOKVIUMI 1. dhe prezentimi i eseve nga studentët</b>
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Evropa në Mesjetën e Hershme - Gjeografia Historike dhe Hartografia Mesjetare</b>
<b>Java e tetë:</b>	<b>Evropa në Mesjetën e Vonshme - Gjeografia Historike dhe Hartografia Mesjetare</b>
<b>Java e nëntë:</b>	<b>Bota Arabe në Periudhën Mesjetare - Gjeografia Historike</b>
<b>Java e dhjetë:</b>	<b>Bota Arabe në Periudhën Mesjetare - Hartografia</b>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<b>Lindja e Mesme dhe e Largët në Periudhën Mesjetare - Gjeografia Historike dhe Hartografia Mesjetare</b>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<b>Amerika Parakolumbiane - Gjeografia Historike dhe Hartografia</b>

<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<b>KOLLOKVIUMI 2. dhe prezentimi i eseve nga studentët</b>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<b>Bota në prag të zbulimeve të Mëdha Gjeografike - Zbulimet Portugeze dhe Hartografia</b>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Zbulimet e Mëdha Gjeografike dhe kolonializmi</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme. Vonesa mbi 10 minuta nuk justifikohet;</li> <li>• Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë ligjërata;</li> <li>• Kopjimi me rastin e kollokviumeve dhe provimit final - i pajustificueshëm;</li> <li>• Shfrytëzimi jo i drejtë i burimeve (plagjiati etj.) me rastin e hartimit të eseve, punimeve seminarike etj. - i ndaluar dhe ndëshkohet;</li> <li>• Çdo kontakt me profesorin e lëndës lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse - në orën e konsultimeve dhe nëpërmjet e-mail adresës zyrtare.</li> </ul>	